

| | | |
|---|--|---|
|  | REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA |  |
| | KOMUNA E MITROVICËS JUGORE OPSTINA.J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA/ | |
| | Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia | |

| | |
|----------------|--|
| NR.PROT | 11-052/01- 0000 826/24 |
| Datë | 03.01.2024 |
| PËR/ TO: | |
| PËRMES/ CC: | |
| NGA/ FROM: | z. Bahtir MAXHUNI Drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia |
| TEMA/ SUBJECT: | Raporti i Punës për vitin 2023 |

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia në muajin **Janar** 2023 aktivitetin e vet të programuar dhe të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera **Nr. 04/L-027** , Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri **Nr. 04/L-012**, Ligjin për Zjarrfikëse dhe Shpëtim **Nr. 04/L-049**, Udhëzimet Administrative, Rregulloren e organizimit të brendshëm të Komunës, Vendimet e Bordit të Drejtorëve si dhe Aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë materie.

I. Gjatë muajit **Janar** Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia ka hartuar dhe azhurnuar këto plane:

- Raportin e punës vjetore për Drejtorinë për Siguri dhe Emergjencia për vitin 2022;
- Hartimin e plan-programit të punës së Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia për vitin 2023.

II. Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Janar 2023** ka realizuar edhe këto detyra:

- Gjatë muajit **Janar** në zyrën e prokurimit kemi dorëzuar udhëzimet për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit: kërkesën për blerjen e kamionave për NJPZSH, furnizimin me pelet për NJPZH, blerjen e gomave për kamiona, bateri dhe zingjirë dimëror për zjarrfiksa, iniciimin për Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi.Tjera, Trajtimin e Qenëve Endacak, renovimin e objektit të stacionit të zjarrfiksave në Mitrovicë, Rrethojen e oborrit të NJPZSH-ës, blerjen komplet të kuzhinës dhe tavolinën e bukës si dhe lavatriqen për NJPZSH-ën.

- ✚ Për shkak të vërshimeve që kanë ndodhur në Komunën tonë kemi formuar dhe aktivizuar Qendrën Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve ku detyrë e kësaj qendre është menaxhimi dhe zbatimi i mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera.
- ✚ Për shkak të dëmeve të konsiderueshme materiale pos komisionit komunal qw wshtw i formuar me vendim tw kryetarit kemi formuar edhe tri komisione AD-HOC për vlerësimin e këtyre dëmeve, një komision është formuar për të bërë vlerësimin e dëmeve tek ekonomitë familjare, një komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë dhe bujqësi, si dhe komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara te bizneset me qëllim të reagimit të menjëhershëm në teren.
- ✚ Gjatë kësaj kohe kemi mbajtur tri mbledhje me anëtarët e Qendrës Operative Emergjente Lokale për Menaxhimin e Vërshimeve dhe katër takime me anëtarët e komisioneve për vlersim dhe evidentim të dëmev nga FN.
- ✚ Së bashku me stafin e komunës kemi qenë afër qytetarëve duke evakuuar familjet që kanë pasur nevoj kemi bërë strehimin dhe furnizimin e tyre me ushqim, barna, veshmbathje dhe pako higjenike. Si dhe kemi marrur vendim për ndarjen e një shumë të konsideruar për kompenzimin e dëmeve tek ekonomit familjare kryesisht të dëmtuara në brendi të shtëpive.
- ✚ Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi marr pjesë në tryezën e diskutimit me temën
 - "Përmbytjet dhe shkaktarët e tyre në Kosovë" të organizuar nga fakullteti i Gjeoshkencave në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Janar**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 315 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Shkurt**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 226 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Gjatë muajit **Mars** kemi marr pjesë në puntorinë për trajtimin e qenve endacak.
- ✚ Gjatë muajit **Mars** është mbajtur seminari një ditor për prezantimin e aspekteve ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin e Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe ndihmë të organizuar nga AME në bashkpunim me OSBE-në ku pjesmarrës kanë qenë: nga një zyrtarë nga drejtorit e Kuvendit Komunal, Policia e Kosovës, Njësia për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Shërbimet emergjente mjeksore, Kryqi i Kuq dega në Mitrovicë, KEDS-i, Eko Regjioni, KLSP, KKSB dhe zyrtarët nga AME.
- ✚ Është mbajtur mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të cilën e kryesoi kryetari i komunës, z. Bedri Hamza.

- ✚ Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e Stacionit Jugor të Policisë, përfaqësues të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Bashkësisë Islame në Mitrovicë, Zjarrfikësve, të Kishës Katolike dhe përfaqësues nga organizata të tjera.
- ✚ Në këtë mbledhje anëtarët e KKSB-së kanë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës: Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Fluksi i madh në trafik, Siguria nëpër shkollat masat e ndërmarra për afrimin e sigurisë, Përpilimi i planit të punës dhe planit të veprimit të KKSB dhe të ndryshme.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencat gjatë muajit **Mars**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 27 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Në bazë të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve në rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera (Vendimi, Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2023 dhe ndryshim Vendimi Nr. 01-020/04-0114631-2/22) dhe evidentimin e dëmeve në ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë dhe bujqësi si pasojë e vërshimeve të shiut në territorin e Komunës së Mitrovicës Jugore, kemi pregaditur dhe dorëzuar në Agjensionin e Menaxhimit Emergjent- **Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës.**
- ✚ Kemi pasur takim pune me zyrtarin e Agjensionit Gjeologjik ku qëllimi i takimit ka qenë vizita e shtëpive në lagjen Bair afër kampit Belvedere.
- ✚ Kemi pasur takim me KFOR-in Hungarez me të cilët kemi diskutuar rreth sigurisë në Komunën e Mitrovicës.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencat gjatë muajit **Prill**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 14 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Gjatë muajit **Maj** kemi pasur takim me LMT -KFOR-in me të cilët kemi diskutuar rreth sigurisë në Komunën e Mitrovicës së Veriut.
- ✚ Së bashku me nënkryetarin vizitua Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim për ditën e ndërgjegjësimit për rëndësinë dhe përdorimin e sigurt të zjarrit -për Ditën Botërore të Zjarrfikësve
- ✚ Takim pune me MPB-AME lidhur me procedurat e fillimit të projektit për programin “Edukimi për Siguri”
- ✚ Takim pune me Policinë e Kosovës
- ✚ Kemi marrë pjesë në puntorinë një ditore me fokus të veçantë në Vlerësimin e Dëmeve pas Fatkeqësisë. Puntoria ka pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve të komunave të prekura më së shumti nga vërshimet e muajit Janar 2023 për të hartuar raporte kualitative të vlerësimit të

- dëmeve. Puntoria është organizuar nga UNDP në bashkpunim me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent AME dhe Kryqin e Kuq të Kosovës.
- ✚ Kemi pasur takim pune me Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim/Spektori për Koordinim të Projekteve, Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve, përfaqësuesin e KLSP në lidhje me projektin “Parandalimi i dukurive të zjarreve”
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Maj**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 14 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Gjatë muajit **Qershor** kemi pasur takim pune me UNDP, AME, KKK lidhur me projektin për rimëkëmbje nga vërshimet të mbështetur nga konsulenti z.Vasko Popovski ku do të hartohet Plani i Veprimit për Rimëkëmbje të Hershme nga Vërshimet duke i pasur si fokus vlerësimin e vërshimeve që janë duke ndodhur në Kosovë si pasojë e ndryshimeve klimatike.
- ✚ Takim pune më përfaqësuesit e AME -MPB dhe inspektorët e ndërtimit pranë drejtorisë së inspeksionit lidhur me fatkeqësinë natyrore rrëshqitjen e dheut në lagjen Bair.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Qershor**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 30 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.
- ✚ Gjatë muajit **Korrik** kemi pasur takim pune me MKRS-në me zyrtarët e inspektoratit për trashigimi kulturore, sektorin e ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit dhe Policisë së Kosovës lidhur me marrjen e masave preventive për evitimin e rrezikshmërisë tek shtëpia e familjes Koroglu.
- ✚ Kemi qenë pjesë e puntorisë me temën hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrishtit në përmbytje për të gjitha basenet, lumenjëve në Kosovë.
- ✚ Kemi pasur takim pune me Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim/Spektori për Koordinim të Projekteve, Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Drejtorinë e Inspeksionit, zyrtarin e agjencionit të pyjeve në lidhje me marrjen e masave në parandalimin e zjarrvënieve në pyje, hapësira publike dhe private.
- ✚ Në Njësinë e Zjarrfikësve në Mitrovicë është bërë pranim dorëzimi i pajisjeve të cilat janë më se të nevojshme dhe do të rrisin efikasitetin e punës së zjarrfikësve.
- ✚ Takim pune me drejtoreshën e Fondacionit për të drejtat e kafshëve. Qëllimi i takimit ishte lidhur me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve që bredhin rrugëve të qytetit.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Korrik**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 19 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin dëmeve nga vërshimet.

- ✚ Gjatë muajit **Gusht** kemi pasur takim pune me zyrtarët e qeverisë lokale të Zveçanit lidhur me planet dhe strategjitë komunale për trajtimin e dukurive të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, për shkëmbimin e përvojës në menaxhimin e ngjarjeve emergjente.
- ✚ Së bashku me zyrtarët e Drejtorisë dhe anëtarët e grupit punues kemi mbajtur takim pune për fillimin e rishikimit gjegjësisht përpunimit të planit Operativ Emergjent për Komunën e Mitrovicës
- ✚ Së bashku me menaxherin e projektit për menaxhimin e trajtimit të qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës kemi vizituar strehimoren e kafshëve shoqëruese Adapt Animals e lincencuar nga autoriteti përgjegjës AVUK.
 - Qëllimi i vizitës ishte të shikohet nga afër trajtimi i qenëve pa pronar duke përdorur sistemin e kastrimit, sterilizimit, vaksionimit etj.
- ✚ Takim pune me IOM-in
- ✚ Takim pune me zyrtarët e Agjencionit për Menaxhimin Emergjent
- ✚ Gjatë muajit **Gusht** është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
 - Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e Stacionit Jugor të Policisë, përfaqësues të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Bashkësisë Islame në Mitrovicë, Zjarrfikësve, të Kishës Katolike dhe përfaqësues nga organizata të tjera.
 - Në këtë mbledhje anëtarët e KKSB-së kanë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës:
 - Gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Mitrovicës së Jugut, analizën rreth vërshimeve në Komunën e Mitrovicës, masat e marrura për siguri në shkolla (fillimi i vitit të ri shkollor) dhe të ndryshme.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Gusht**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 15 kërkesa me shkrim nga qytetarët.
- ✚ Gjatë muajit **Shtator** 2023 së bashku me stafin e drejtorisë kemi pasur takim me përfaqësuesin e UN HABITAT i cili na ka ofruar mbështetje dhe përkrahje për familjet e prekura nga vërshimet.
 - Vizita në terren kanë filluar me dt, 12.09.2023 deri me 22.09.2023 ku gjatë vizitës në teren grupi punues ka kryer fotografimin e gjendjes si dhe i kanë identifikuar nevojat e banorëve të prekur nga vërshimet.
- ✚ Është mbajtur puntori me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe këshillat komunale për siguri në bashkësi nga Komunitatet e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajit.
- ✚ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia gjatë muajit **Shtator**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 4 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

-  Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca për shkak të punimeve që janë duke vazhduar në rrugën “Ali Zeneli” me dt 08.10.2023 ka angazhuar Shërbimin për Zjarrfikje dhe Shpëtim, KEDS-in, Policinë e Kosovës, kompaninë kontraktuese dhe zyrtarët e komunës ku së bashku kanë larguar dy drunjë që gjenden përball xhamisë “Isa Beg”.

Kjo ndërhyrje e largimit të plepave ka qenë e nevojshme për të siguruar dhe mundësuar qasjen në rrugën Ali Zeneli që punimet rrugore të zhvillohen në mënyrë efikase.

-  Së bashku me Kryetarinë e Komunës kemi zhvilluar një takim me zëvendësministrin e Mbrojtjes, ku të pranishëm kanë qenë edhe zyrtarët e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Qëllimi i këtij takimi ka qenë mundësia e bashkpunimit në fushën e gatishmërisë për menaxhimin e emergjencave natyrore dhe fatkeqësive tjera.
-  Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.
-  Kemi mbajtur një takim pune me zyrtarët komunal që janë pjesë e Planit Operativ Emergjent
-  Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Tetor**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 5 kërkesa me shkrim nga qytetarët.
-  Gjatë muajit **Nëntor** kemi angazhuar Operatorin Ekonomik që të bëjë pastrimin e lumit Lushta nga mbeturinat dhe materialet e ndryshme për evitimin e dëmeve si masë preventive për minimizimin e pasojave.
-  Gjithashtu kemi qenë në rajonin e Shalës së Bajgorës për të verifikuar gjendjen e rrugëve dhe rëshqitjes së dheut në rrugë.
-  Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Nëntor**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 27 kërkesa me shkrim nga qytetarët.
-  Gjatë muajit **Dhjetor** është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)
 - Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesi i Stacionit Jugor të Policisë, Komandanti i Njësisë për Zjarrfikje dhe Shpëtim, përfaqësuesi i Kishës Protestante dhe përfaqësues nga organizata të tjera.
 - Në këtë mbledhje anëtarët e KKSBB-së kanë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës:
 - Gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Mitrovicës së Jugut, pregaditjet për marrjen e masave preventive nga vërshimet në Komunën e Mitrovicës së Jugut, masat e ndërmarrura për siguri nëpër shkolla lidhur me rrezikun nga përdorimi i fiskekzjarrëve dhe të ndryshme.
-  Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.
-  Për shkak të rëshqitjes së dheut në rrugë në fshatin Stan Tërg kemi ndërtuar një muri mbrojtës
-  Kemi bërë renovimin e kulmeve të shkollës së Zhabarit, shkollës Ismail Qemajli dhe shkollës së Vllahisë të cilat janë dëmtuar nga erërat e mëdha.

- ✦ Së bashku me përfaqësuesin e UN Habitat kemi bërë shpërndarjen e teknikës së bardhë te familjet e dëmtuara nga vërshimet.
- ✦ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Dhjetor**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 12 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

